

Arb. G. Gede



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER VALBONA P. SINANI
ADRESA NR.2, GEORGE W. BUSH,
PALL"ALBSIG", NR.1, NR.12
TEL: 693326497

KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 1959

Nr. koleksioni: 814

Tirane më 03/06/2025

Digitally signed by
VALBONA SINANI

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 124/2024, datë 19/12/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale"
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar



A2025051460091024684

*Akti noterial përbëhet nga 5 fletë



A2025051460091024684

**KONTRATË SHITJE KUOTE KAPITALI****(TË SHOQËRISË “MR GREEK ALBANIA” SH.P.K)**

Sot, më datë 03.06.2025, para meje Notere VALBONA P. SINANI, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NR.2, GEORGE W. BUSH, PALL"ALBSIG", NR.1, NR.12, u paraqit personalisht:

SHITES:

VIKTOR LAGJI, atësia Gramoz, amësia Majlinda, shtetas Shqiptar, lindur në Vlorë dhe banues në adresë Mustafa Bega; Vlorë, lindur më 15/08/1989, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 038515122 dhe nr. personal I90815060U.

(ne cilesine e ortakeut te vetem te Shoqerise “MR GREEK ALBANIA” sh.p.k.)

(ketu e me poshte Shitesi)

BLERES:

MIREN REÇI, atësia Jetmond, amësia Ermira, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në adresë Memo Meto; Tiranë, lindur më 23/10/1983, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033818471 dhe nr. personal I31023002G.

(ketu e me poshte Bleresi)

Pasi verifikova statusin ligjor të palëve të sipërpërmendura, Unë Noterja konstatova se ato janë në përputhje të plotë me ligjin. Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë neni 705 e vijues i tij, si dhe Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, bien dakord dhe kërkojnë nga Unë Noterja **redaktimin e Kontratës së Shitjes të kuotave të kapitalit të Shoqërisë MR GREEK ALBANIA**, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra kombëtare e bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NUIS M51328028Q, me adresë Durres, Fushe Kruje, Rinas Aeroporti Nderkombetar Nene Tereza, **përfaqësuar nga Administratori VIKTOR LAGJI**, atësia Gramoz, amësia Majlinda, shtetas Shqiptar, lindur në Vlorë dhe banues në Vlorë, lindur më 15/08/1989, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 038515122 dhe nr. personal I90815060U, **sipas kushteve dhe përcaktimeve ligjore të mëposhtme:**

Baza Ligjore

- Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 705 dhe vijues të tij;
- Neni 761 e vijues të Kodit Civil
- Neni 73, pika 1, gërma “ç” (për kuotat e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar ose neni 117, pika 1, gërma “ç” (për aksionet e shoqërive aksionare/anonime) të Ligjit nr. 9901, datë 14.08.2009 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar
- Neni 62, gërma “II”, neni 63, pika 1, gërma “ç”, si dhe nenet 99, 100, 101 e vijues të Ligjit nr. 110/2018, datë 20.12.2018 “Për Noterinë”



A2025031460091024684

NENI 1 OBJEKTI I KONTRATËS

Shoqëria "MR GREEK ALBANIA" shpk, e themeluar me date 24.01.2025 dhe e regjistruar ne Q.K.B date 28.01.2025, me N.I.P.T M51328028Q, me Administrator **VIKTOR LAGJI** dhe Ortak te vetem **VIKTOR LAGJI**, zoterues i 1,00 te kuotave qe perfaqeson 100% te kapitalit fillestar ne shumen 100.000,00 leke, me objekt veprimtarie sipas statutit dhe aktit te themelimit.

Ortaku i Shoqërise "MR GREEK ALBANIA" shpk, **VIKTOR LAGJI**, me vendimin date 02.06.2025 te asamblese se ortakut te vetem ka vendosur shitjen nepermjet kontrates se shitjes të 49% te kuotave te kapitalit që zoteron ne këtë shoqëri, blerësit **MIREĐ REČI**.

VIKTOR LAGJI do te jete ortak me 51% te kuotave dhe njekohesisht do vazhdoje te jete administrator i shoqërise "MR GREEK ALBANIA" shpk.

NENI 2 ÇMIMI I SHITJES DHE MËNYRA E PAGESËS

Çmimi total i Shitjes për shitjen e kuotave te kapitalit dhe është në shumën prej **49.000,00 leke** (dyzet e nente mije leke).

Pagesa eshte likuuduar mes paleve jashte kesaj zyre noteriale perpara nenshkrimit te kesaj kontrate dhe palet nuk kane asnje pretendim financiar kundrejt njerit tjetrit ne lidhje me shitjen e kuotave te Shoqërise MR GREEK ALBANIA sh.p.k. as sot dhe as ne te ardhmen.

Kjo Kontrate do te regjistrohet prane Qendres Kombetare te Biznesit ne momentin e nenshkrimit te saj nga **Z. VIKTOR LAGJI**, brenda afatit te percaktuar ne ligj.

NENI 3 DEKLARIMET DHE GARANCITË E SHITESIT

Me nënshkrimin e kësaj kontrate shitblerje te kuotave te kapitalit nga palet, Shitesi **VIKTOR LAGJI** merr përsipër detyrimin të transferojë titullin e pronësisë se 49% te kuotave te kapitalit te Blerësit **MIREĐ REČI**.

Ne momentin e nenshkrimit te kesaj Kontrate shitblerje, Shitesi **VIKTOR LAGJI** do te zoteroje 51% te kuotave te kapitalit themeltar, dhe do te vazhdoje te qendroje si administrator i shoqërise "MR GREEK ALBANIA" shpk.

Pas regjistrimit te saj prane organit perkates, bleresi **MIREĐ REČI** do te zoteroje 49% te kuotave te kapitalit themeltar te shoqërise "MR GREEK ALBANIA" shpk.

Administrator i Shoqërise "MR GREEK ALBANIA" shpk, do te vazhdoje te jete **VIKTOR LAGJI**.

- Shitesi deklaron dhe garanton se tatimi ne burim ne shtet eshte detyrim i tij.



A2025051460091024684

- Shitesi deklaron dhe garanton se per cdo gjobe, penalitet, pagese te prapambetur ne shtet si takse/tatim e jo vetem, pergjegjes per likujdimin e saj eshte vetem pala shitese pavaresisht faktit nese bleresi ka dijeni apo jo per te.
- Shitesi deklaron dhe garanton se eshte pronar dhe përfitues i vetëm dhe i ligjshëm i të gjithë kuotes që përbën 100% të kapitalit të shoqërisë “MR GREEK ALBANIA”sh.p.k.
- Kuota qe shitet eshte e lire dhe e çliruar nga çdo barrë e çfarëdo lloji dhe Shitesi ka të gjitha të drejtat, kompetencën dhe autorizimin e plotë për t’i shitur, për t’i kaluar, transferuar dhe dorëzuar kuotat.
- Asnjë person nuk pretendon se ka ndonjë të drejtë lidhur me ndonjë nga kuotat e shoqërisë “MR GREEK ALBANIA”sh.p.k.
- Shitesi garanton se cdo detyrim te papaguar, takse qe shoqëria “MR GREEK ALBANIA” sh.p.k. ka ne momentin e nënshkrimit te kontrates do te paguhet prej tij dhe nuk ka rënë dakord të krijojë ose të marri hua, të marri borxh ose detyrime të natyrës së huamarrjes, nuk eshte palë dhe nuk eshte përgjegjës në bazë të ndonjë marrëveshjeje siguruese, dëmshpërblimi ose marrëveshjeje tjetër për të siguruar ose marrë përsipër ndonjë detyrim financiar ose detyrim tjetër në lidhje me detyrimet e një pale të tretë.
- Shitesi deklaron se nuk ka asnjë proces gjyqësor civil, penal, apo administrativ dhe as në ngarkim të shoqërisë në Republikën e Shqipërisë me objekt kuotat e tij.
- Shitesi do të mbajë të pacënuar Bleresin për çdo detyrim tatimor të paparashikueshëm që rrjedh nga akte, fakte ose mosveprime të ndodhura para nënshkrimit të kontratës.
- Shitesi do të mbajë të pacënuar Bleresin nga çdo dhe të gjitha pretendimet e bëra nga palët e treta, si për shembull por jo në mënyrë shteruese: shumat e detyrueshme për palët e treta në përgjithësi për çdo titull ose arsye dhe çdo detyrim tjetër.

NENI 4

DEKLARIMET DHE GARANCITË E BLERËSIT

Bleresi garanton Shitesin se ka të gjithë autorizimin për të nënshkruar këtë kontratë dhe ka kompetenca dhe autoritet të plotë të kryejë aktivitetin e tij.

NENI 5

REGJISTRIMI I KONTRATËS

Kjo kontratë shitblerje kuotash kapitali do te regjistrohet prane Qendres Kombetar te Biznesit nga pala blerese ne regjistrin e kuotave të shoqërisë dhe në Regjistrin Tregtar në përputhje me ligjin ne momentin e likujdimit te cmimit te plote te shitjes.

NENI 6

FORCA MADHORE

- Mospërmbushja e detyrimeve sipas kësaj kontrate prej njëres nga Palët, nuk do të quhet shkelje ose mospërmbushje e kësaj kontrate, në rast se kjo mospërmbushje vjen si pasojë e një force madhore, me kusht që Pala e prekur nga kjo ngjarje (a) të ketë marrë të gjitha masat paraprake të arsyeshme, përkujdesjen e duhur dhe masa të ndryshme të arsyeshme, për të përmbushur afatet dhe kushtet e kësaj kontrate, dhe (b) të ketë njoftuar Palën tjetër sa më shpejt e mundur për këtë ngjarje.
- Çdo periudhë brenda së cilës, njëra nga Palët sipas kësaj Kontrate, duhet të kryejë një veprim ose detyrë, do të zgjatet për një periudhë kohe të barabartë me periudhën gjatë së cilës kjo Palë, nuk mund të kryejë këtë veprim për shkak të forcës madhore.



A2025051460091024684

NENI 7**PËRFUNDIMI I KONTRATËS**

Me nënshkrimin e rregullt nga palët kjo kontratë konsiderohet e përfunduar me sukses.

NENI 8**ZGJIDHJA E KONTRATËS**

Kjo kontratë mund të zgjidhet me marrëveshje të përbashkët me shkrim ndërmjet Shitesit dhe Bleresit, duke i kthyer palët në gjendjen fillestare siç ishin para nënshkrimit të kësaj kontrate ose sipas kushteve të parashikuara në kete kontratë. Kjo kontratë mund të zgjidhet në mënyrë të njëanshme nga pala shitesë nëse nuk respektohet afati i pagesës së cmimit të plotë të shitjes

NENI 9**INTERPRETIMI I KONTRATËS**

Kontrata duhet të interpretohet në mirëbesim nga palët. Kushtet e përcaktuara në këtë kontratë interpretohen pa u ndalur në kuptimin letrar të fjalëve, por duke pasur parasysh qëllimin e vërtetë të palëve që i ka shtyrë për nënshkrimin e aktit.

NENI 10**NJOFTIMET**

- Çdo njoftim mbi ekzekutimin e kësaj kontrate, pretendime të tjera apo edhe zgjidhjen e saj, do të njoftohet me shkrim.
- Secila palë kontraktore ka detyrimin që të njoftojë tjetrën për çdo ndryshim të dhënave të adresës së saj, në të kundërt nuk ka vend për përgjegjësi kundrejt palës tjetër. Në rast se nuk përmbushet ky detyrim, pala që ka kryer njoftimin konsiderohet se e ka përmbushur detyrimin.

NENI 11**ANEKSET E KONTRATËS**

Kësaj kontrate i bashkëlidhen si pjesë përbërëse dhe të pandarë këto dokumente që do të quhen Aneks të Kontratës;

- Vendimi i Ortakut të Shoqërisë datë 02.06.2025;
- Ekstrakt i Regjistrimit Tregtar për Shoqërinë “MR GREEK ALBANIA “Sh.p.k.;
- Informacioni i marrë nga Regjistri i Barrëve Siguruese, Tiranë;
- Dokumentet e identifikimit të palëve kontraktuese.

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Kontrata e Shitjes të kuotave të kapitalit u lexua nga unë Noterja me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të Palëve kontraktuese të cilët më deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse shprehin vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje Noteres.



A2025051460091024684

Unë Noterja, verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62 të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 “Për Noterinë”, vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të Ligjit 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave Personale”, unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përputhoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

PALËT KONTRAKTUESE

SHITES

VIKTOR LAGJI

(ortak i Shoqerise “MR GREEK ALBANIA” Sh.p.k.)

BLERES

MIRED REÇI

NOTER
VALBONA P. SINANI

